KOMBÊTARE
BIBLIOTEKA
88
C
83
TIRANË

ÉJOTEKA DHE MUZEJA KOMBÊTARE
TIRANË

VEPÊRIJ'

e

BIBLÉJOTEKÉS' KOMBÊTARE

gjatë vitit'
1929

BKSH

TIRANË
Shtyp. „Mbrothësija" Kristo P. Luarasi
1930

KOMBÊTARE
BIBLIOTEKA
88
C
83
TIRANË

KOMBËTARE
BIBLIOTEKA
88
C
83
TIRANË

BKSH

02
13 17:1

02
B471

BIBLËJOTEKA DHE MUZEJA KOMBËTARE
TIRANË

VEPËRIJ'

e

BIBLËJOTEKËS' KOMBËTARE

gjatë vitit'
1929

BKSH

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
BIBLIOTEKA KOMBËTARE
TIRANË

TIRANË
Shtyp. „Mbrothësija" Kristo P. Luarasi
1930

BKSH

Veprij' e Biblëjotekës' dhe Muzejës' Kombëtare - Tiranë

gjatë vitit' 1929

VERBALI

i mbëledhës' së Kumësijës' së Biblëjotekës' dhe Muzejës Kombëtare mbë 22 të Korrikut' 1930, mbë 11 h. të mëngjezitë.

Undodhënë:

Z. Mid'hat Frashëri
„ Niazi Tirana
„ Shundi (Dr. Athanas)
„ Toçi (Dr. Terenc)
dhe „ Kolea (S.)

Puna e ditësë:

1) . . . . . .
2) . . . . . .

Biblëjoteka dhe Muzeja Kombëtare mbë 1929

. . . . . .

Përparimet' të Biblëjotekës' Kombëtare për këtë vit të dytë, kapërxyenë plot' pashënë edhe kufirin' e shpëresavet' që ushpërhejtën' ndë raportën' e vjelme.

Të hyratë. Për vitin' 1929 ushënuanë:

5240 vozitës' për 319 ditë pune
ballë 1785 vehtave për 250 ditë pune mbë 1928.

Të shtuarët' të kryeplotëm' të vozitësvet' harrin:

3455 vehta, dhe, ndë mënyrë të përpjesëtë, — tukë marurë ndë fill sumimi numurin' e ditëvet' — shënon një tepëricë
prej 2963 vehtave, baras me afëro 130%.

Ditët' me numur' vozitës' mëë të plotë qenë:

e djela	9 Qershuar	me 57 vehtë
e diela	10 Vjesht' e Tretë	„ 53 „
e djela	8 Dimëruar	„ 65 „

BKSH

Këta numura — sidomos ndëë umartë para sysh të ngushtët' të sallës' së këndimitë ndë selijën' e vjelme të Biblëjotekës' Kombëtare — janë një penk i gjallë i dikës' që kanë bota e Kryeqytetitë për mësim dhe për shvillim të mëndjesë.

Vivëlla të kënduara. Simvjet ukërkuanë për këndim ndë këthinën' e Biblëjotekësë:

1915 vëpëra të ndryshëme
faqe 459 për vitin' 1928.

Edhe ndë këtë degë, pra, Biblëjoteka Kombëtare ka të shënonjë një përparim të kënaqëshmë, përparim i cili kapërxen të 42%, ndë përpjesë me vitin' e kaluarë.

Vivëllat' që ukënduanë ndahenë ndë:

1602	vepëra	shqip	(262 mbë 1928)
154	„	frëngjisht	(94 „ „)
67	„	italisht	(22 „ „)
47	„	inglisht	(69 „ „)
27	„	turqisht	(8 „ „)
13	„	gjermanisht	(4 „ „)
2	„	greqisht	(— „ „)
2	„	sërbisht	(— „ „)
1	„	rumanisht	(— „ „)
1915			459

Veç këtyre ushënua se mbë 1929 një shumicë vozitës të Biblëjotekësë umuarën' mëë shumë se vitin' e parë me vepërat' (279 copë) të lëshuara për këndim të lirë ndë sallën' e këndimitë.

Ushënua edhe-mëë se të 95% të vivëllavet' të kërkuara ndë gjuhë të huaja qenë vepëra që maren' me albanologjijënë.

Vivëlla të falura. Viti 1929 është për të shënuarë me porre të bardhë për dhuratat' të shuma dhe me vlejë të madhe që i ubënë Biblëjotekës' Kombëtare nga miq' e dashamirë.

Këto dhurata sumohen' gjithësejit' me:

1804 copë vivëlla të ndryshëme
67 copë rëvista
309 numura gazetash shqip të vjetëra.

Ndë shkallë të parë vjen dhurata e çëmuarë që i bëri Biblëjotekësë N. M. e Tij' Mbëreti, tuke i falurë:

1440 copë vivëlla që pat' lënë ndë urdhërin' e Tijë Z. Gj. Çako.

Bksh

Nje dhuratë me vlejë për lëndën' e vepëravet' që përshin po dhe ca mëë tepërë për mënyrën' fisnike të të faluritë, është ajo që i beri Biblëjotekës' Kombëtare albanologës' i ndritëshmë Zoti Prof. Dr. Vajgant (Prof. Dr. G. Weigand) nga Lëpiska (Leipzig).

Nga muaji i Gushtit' 1929 Z. Vajgant i pat' çuarë Drejtorijësë një listë prej afëro 200 vepërash, me porosijë që t' i shënohëshin' të pa-ndodhurat' ndë Biblëjotekë, për t' i a falurë.

Shënimet' të Drejtorijës' mbi listën' ndë fjalë përshitjen' 81 copë vivëlla, nga të cilat' shumica e madhe qenë vepëra të motëshme shqip dhe për gjuhën' edhe kombin' Shqipëtar, të shdukura qëë moti nga tregu i librërijësë.

Gjithë vepërat' të shënuara dhe bashkë me 'to edhe 178 numura gazetash shqip të vjetëra, të falura nga Z. Profesor Vajgant i udorezuanë Drejtorijësë ndë Dimëruar 1929, tuke begatuarë degën' e albanologjijës' së Biblëjotekës' Kombëtare me vepëra që me të vishtirë dot' munt t' i kishte mé anë të jetërë.

Një begatim i çëmuarë për së tepëri janë 25 fletore shënimesh mbi të folët' shqip të viseve të ndryshëm' të Greqijësë, të mbëledhur' dhe të shkruarë me dorë të albanologut' Z. Dr. Rainholld (Dr. Reinhold) gjatë vitevet' 1856 gjer 1858.

Për të shenuarë edhe-mëë është dhurata që i bëri Biblëjotekës' Zoti Leon Naçi nga Aleksandër' e Misiritë. Ky atdhetar i kohës' së herëshme na çoj' 5 vepëra të Kostandin Sathësë, që kanë të bëjën' me punë të motëshme të Shqipërijësë dhe që nuk' gjinden' mëë për t' ublerë

T' jera dhurata kemi të shënojëm':

16 copë vivëlla të faluna prej Z-jes' së tijë Z. Hil Mosi
53 rëvista „ „ „ „ „ „ „ „
131 numura gazetash shqip të vjetëra „ „ „ „ „
36 copë vivëlla fali Z. Aleks. Jan Pjetri — Durrësë
8 „ „ „ Z. Dhori Koti — Korçë
8 „ „ „ Z. Kristo Luarasi — Tiranë
8 „ „ falën ZZ. Peppo dhe Marko — Korçë
6 „ „ fali Gazeta e Korçësë — Korçë

5 copë vivëlla fali Z. Mexhit Jegeni — Tiranë
4 „ „ „ Z Hafës Ibrahim Dalliu — Tiranë (vepëra të vehta)
79 cope vivëlla fali Z. S. Kolea — Tiranë
14 copë rëvista inglisht fali Z Prof. Sam. Irvin — Kavajë
Nga vënde të jashtëm falën':
5 copë vivëlla Z. Prof. N. Jokl — Vjenë (vepëra të vehta)
28 „ „ Ahmadija Anxhuman-i Isha' at-i Islam nga Lahora (Hint).

Përveç këtyre Biblëjoteka Kombëtare pati dhurata:
1) nga Ufica të Ufiqëta:
nga Sherijati i Shqipërijësë
„ Mënistërij' e Punëvet' të Jashtëme
„ Mënistërij' e Ekonomijës' Kombëtare
„ Mënistërij' e Drejtësijësë
„ Drejtorija e Përgjithëshm' e Shëndetësijësë
„ „ „ e Djelmënijës' Kombëtare
„ Legata e Francësë
„ Banka Kombëtare e Shqiperijësë
„ Shkolla Teknike — Tiranë
Dhe nga vënde të jashtëmë:
nga Biblëjoteka e Dhomës' Tregëtare të Marsijlësë.
2) nga vënde të ndryshëm' të Shqipërijësë falën:
ZZ. At Ali Tyrabiu — Skrapar (vepra të vehta)
Ferit Vokopola — Tiranë („ „ „)
Avukat V. K. Dilo „ („ „ „)
Mid' hat Frashëri „ („ „ „)
L. Çeta „ („ „ „)
Prof. L. Ugolini „ („ „ „)
S. Papahristo Korçë („ „ „)
Llambi Dardha „ („ „ „)
I. M. Qafëzezi „ („ „ „)
Ernest Koliqi Shkodërë („ „ „)
Hamit Gjylbegaj Elbasan („ „ „)
Shoqërija Stamles Durrësë (raportën' e vititë)
Gafur Bakllava — Tiranë

dhe nga vende të huajë:

ZZ. Bogdan Zagorski	— Varshavë	(vepëra të vehta)
Must. Kruja	Zara	(„ „ „)
Kost. Kote	„	(„ „ „)

Dhurata e Bashkijës' së Tiranësë. Bashkija e Tiranësë pati mirësijën' të kujtonjë simvjet Biblëjotekën' Kombëtare tuke i shënuarë një sumë prej ..... **Fr. ari 500.**

Kjo dhuratë u përdor për të blerë 55 copë vivëlla për mëë shumë vepëra pedagogjije që nuk' i ndodheshin' Biblëjotekësë.

Rëvista dhe gazeta të vjetëra. Me gëzim të math ushënuanë simvjet per të parën' herë dhurata rëvistash dhe gazetash të vjetëra shqip, të bëra nga ZZ. Prof. Dr. Vajgant dhe Hil Mosi.

Shëmbëllën' e këtyre Zoterinjve e ndoqën' dhe t' jerë, të shumë, atdhetarë dhe dashamirë të Biblëjotekës' Kombëtare, dhuratat' të të cilëvet' kanë për t' upërmbëledhurë ndë raportën' e vitit' 1930.

Drejtorija dhe Kumësija e Biblëjotekës' Kombëtare kanë shpëresë se me anë dhuratash të ra dot' kihet' fati i mbarë të plotnohen' rjeshtat' të gazet'-e rëvistave të vjetëra, që shpërfaqin' dita-ditësë, jetën' e Shqipërijës' ndë kohën' e tmerrëshme të luftes' së rrebëtë kundër' Qeverrijës' së Tyrqijës' së Sulltan Hamidit' dhe të Tyrqëvet' të rinjë.

Vivëlla të marura nga Mënistërij' e Arësimitë. Mënistërij' e Arësimitë na çoj' simvjet:

155 copë vivëlla, dhe

4 karta gjëjugrafije të vjetëra të Shqipërijësë, që pati blerë për Biblëjotekënë.

Vivëlla të blera. Gjatë vitit' 1929 ublene: 282 copë vivëlla.

Vepëra e Don Gjon Buzukutë. Biblëjoteka Kombëtare ubegatua simvjet me nje vivëllë, që kujtohet' se është e para vepërë shqip që dolli ndë ndritë me anën' e shtypitë.

Kjo vepërë është Mëshari pas lëturgjijës' Katolike i këthyerë shqip prej Don Gjon Buzukutë dhe i shtypurë mbë 1554-1555, ndofta ndë Shkodërë.

Për shkaqe që nuk' dihenë mirë ky Meshar ka qënë shdukurë dhe ka shpëtuarë vetëm' një ksombëlë e cila gjindet' sot ndë Biblëjotekën' e Vatikanit' ndë Romë.

Mpështeturë mbi lajme që kishin' burimin' nga Llondëra, Drejtorija e Biblëjotekës' Kombëtare pyeti Drejtorijën' e Muzejës Britane (British Museum) për vepërën' e Don Gjon Buzukutë. Nga të përgjegjet' te Muzejës' Britane mësuamë se as atje as njgjëtiu ndëpër Biblëjotekat' të Inglijësë dihësh' të ndodhet' Meshari shqip.

Lajëme t' jera vërtetojën' gjithaqë për Biblëjotekat' të Vjenës' dhe të Venedikutë.

Ndofta kërkime dhe vështgjime mëë të hollë dot' xbulojën' ndonjë ksombëlë te pa-njohurë gjer sot ndë Biblëjoteka t' jera(Napëlë, Madrid, Zagreb, Ajnoros të Greqijësë etj.)

Sido qoftë puna, Mënistërij' e Arësimitë, me të ysturit' të Uratavet' të tyre Etërvet' Franqëskanë të Shkodrësë, ndau të marinj' pak së paku, një të ngriturë me fotografijë të ksombëlës' së Mesharit' të Vatikanitë, dhe me këtë dëtyrë të ho lë ngarkoj' Uratën' e tijë At Gjystin Rrotënë.

Puna ukrye për së mbari gjatë vitit' 1929 dhe upatën' tri të ngritura, nga të cilat' një i udorëzua Biblëjotekës' Kombëtare.

Vepëra e Don Gjon Buzukutë' e shkruarë ndë të folë të Shqipërijës' së Veritë, të përzjerë me shumë forma që janë ruajturë gjer mbë sot ndë të folët' të Shqipërijës' së Jugutë, është shtypurë me shkronja goto-lëtine.

Për tingëllat' të gjuhës' shqip, që i mëngojën' kësaj abeceje, kan' qenë përdorurë shkronja të posaqëme, të shëmbëllejtura ndo nga gllagoliteja ndo nga abeceja e Shqehëvetë.

I cenuarë ndë krye dhe ndë funt, Meshari përshin sot 188 faqe të plota dhe lladica 2 faqesh ndë krye dhe 8 faqesh ndë funt.

Mbas si mungon faqeja e fundit' nuk' munt të dihet' për së vërteti sa faqesh ka qënë vepëra e plotë.

Bashkë me dy lladicat' të kryesë mungojën' nga vepëra

Fletët	1	gjer	8	= faqe	16
„	27	„	29	= „	6
„	33	„	36	= „	8
Fleta	63			= „	2

dhe faqet' të fundit' që nuk' dihet' sa kanë qënë.

Numurim' i fletëvet' ësht' i gabuarë ndë shumë vise ; për shëmbëllë :

fleta Nr. 61 është shënuarë me numurë 59 ; pas soje vijën' me rjegëllë fletët' Nr. 62 gjer 64 ; po ndë vënt të Nr-it 65 nis një rjesht' e re me Nr. 55 dhe vete me rjegëllë gjer te Nr. 88, pas të cilit' fillon një rjesht' e re nga Nr. 79 për të mbaruarë ndë Nr. 90.

Nuk' mbetet' as hije ndyshimi se Meshar' i Don Gjon Buzukutë dot' jet' mblojtur' me gabime fjalësh, shkronjash etj. po me gjithë këtë kjo vepërë është një monomentë me vlejë të pa-të-çëmuarë për gjuhënë shqip, se, gjer mbë sot, ësht' e vetëma pasqyrë e gjallë që na tregon mënyrën' e të folurit' dhe format' që përdornin' stërgjyshët' t'anë të sot e 400 vjetë mëë parë.

Dijëtarët' t' anë dhe albanologësit' të huajë kanë për të gjetur' ndë Mesharin' e Don Gjon Buzukutë lëndë me vlejë dhe me vërshë për shqyrëtime gjuhësije.

Gazeta dhe rëvista. Gjatë vitit' 1929 umuarën me rjegëllë ndë Biblëjotekën' Kombëtare :

gazetatë :	Arbënija	Tiranë
	Ora	„
	Vullneti i Popullitë	„
	Gazeta e Korçësë	Korçë
	Zëri i Korçësë	„
	Demokratija	Gjinokastërë
	Gazeta Shqipëtare	Bari (Italjë)
	Shqipërija e Re	Kostanxë (Rumanijë)
	Djelli	Boston Mass. (U. S. A.)
	Le Temps	Paris
rëvistatë :	Ora	Tiranë
	Bujqësija	„
	Edukata e Re	„
	Fletoreja Zyrtare	„
	Laboremus	„
	Shqipëtarja	„
	Zâni i Naltë	„

PKSH

Leka	Shkodërë
Studenti Shqipëtar	Torino (Italjë)
The Light	Lahorë (Hint)
Illustration	Paris
Revue des Deux Mondes	„
La Revue Bulgare	Sofje
Peninsula Balcanica	Bukuresht

dhe me pajtesë:

Near East and India	Llondërë
Nuova Antologia	Romë
Je sais tout	Paris

Ditë pushimi. Mbë 1928 Biblëjoteka Kombëtare nuk' pati as një ditë pushimi të përjavëshmë, si ç' është për gjithë uficat' të ufiqeta të Mbëretërijësë dhe për gjithë biblëjotekat' të botësë. Për pakë mëë se tetë muajë kohë upunua rreshtë 250 ditë.

Për vitin' 1929, enish, me pëlqim të Mënistërijës' së Arësimitë, unda një ditë për pushim të përjavëshmë.

Ndë krye, 18 Mars gjer 19 Gusht, Biblëjoteka pati të hënënë si ditë pushimi. Po mbas si edhe Biblëjoteka për Djelmërijënë, që çeli ndë Korrik 1929, zgjodhi muu atë ditë për pushimin' e vehtë, ugjet' me udhë të ndryshohet' programa e Biblëjotekës' Kombëtare, për mos të lënë miqët' të mësimit' ndë Kryeqytet pa biblëjotekë të çelurë për nji ditë të tërë.

Tuke nisurë qëë mbë 24 të Gushtitë ushënua e shëtuna si ditë pushimi për Biblëjotekën' Kombëtare, dhe kjo mbeti gjer në funt të vititë.

Orari i punësë. Si për vitin' 1928, orari i përditëshmë për të vozitur' bota ndë Biblëjoteken' Kombëtare qe me aftë i gjërë dhe i caktuarë ndë mënyrë që mos të pengohet' kush nga puna e përvehtëtë.

Selija e re e Biblëjotekësë. Ndë krye të vitit' që jemi (1930) Biblëjoteka dhe Muzeja Kombëtare umbartën' ndë godinë të jetërë, shumë mëë të gjërë se e para, ku ngushtica e vënditë qe një pengim i math i ç' do përparimi.

Tashti-mëë shpëresa ësht' e madhe se ndë raportën' e vitit 1930 dot' kemi të shënojëm' t' jerë përparime, ndonëse, nga shkaku i mbartjesë, Biblëjoteka mbeti e mbyllurë për dy muajë kohë.

Muzeja Kombëtare

Ndë raportën e vitit' 1928 nuk' umunt të bëhet' as fjalë për Muzejën' Kombëtare.

Si për gjithë mungesat' t' jera shkaku qe ngushtica e vëndit ë.

Nje Muzejë, sado e vogël' qoftë, nuk' munt të ormitet' pa pasur' vënt dhe vënt të gjerë.

Kemi shpëresë se ndë selijën' e re diç dot' munt të navatetë dhe se një pjes' e sendevet' mëë të zgjedhura të Muzejës' Kombëtare dot' munt të qellen' përpara botësë.

Shënimet' që kanë për t' ushtruarë këtu pas janë të pakë dhe të përcipëtë; hollësija mëë të plota kanë për t' upërmbledhurë ndë raportën' për vitin' 1930.

Gjatë vitit' te kaluarë Muzeja Kombëtare ubegatua:

1) Me sendet' të xbuluara ndë Nekropolën' e herëshme të Leshitë ndë Maj 1929.

Ndër këto janë për të shënuarë.

Një unazë ramitë me brumbull ndë vënt guri, të kalitur' me bukurijë.

Nji gur unaze me kryë luftëtari, të gërvishturë.

Dy sqyre të baltëta, të pa-cenuara, nga të cilat' njëra e lajlitur' me mjeshtërijë të madhe me bruzhdulla per rreth buzësë dhe me 3 mjellma edhe 3 kurora dafine për rreth funditë.

Një garuzhdë ramitë, për poçe gjalpi, vaji ose dhe mjalti të shkrijturë, e pa cenuarë, me, ndë majë të bishtitë, një kokë mjellme të punuarë për bukurijë.

Një thikë, ramitë, të formës' së thikavet' që përdornin' Jëlirëtë dhe që quhen' me emrin e tyre (thika Jëlirësh).

Disa lyqerë të baltëtë, nga të cilët' 3 të xbukuruarë me fëtyra perëndijësh o me lajla të spikatura.

Tri maja shtijëzash prej rami, të ruajtura mirë.

Një shumicë qeftesh, këlshejtash, filltarësh, poçesh, vorbash të vogëla etj. ndër të cilëtë disa të xbukuruarë me njgjyjëra o me lajëla.

Bukurija e punës' së gjithë këtyre sendeve dhe trajta e të vetmit' varr që uxbulua i pa-cenuarë, kufisin' vjetërsijën' e tyre ndërmjet të I shekull para Krishtitë dhe të I pas sijë. 2). Me katërë krerë shtatëlash të gurtë, të gjeturë ndë Vithrënëtë (Vithtraatë, Butrinto) gjatë gërrmimevet' që ësht' e bën nd' atë qytet të herëshmë arqejologësi Italjan Zoti Prof. L. N. Ugolini me shokët' të tijë.

Këta krerë, njëri syresh krejet' i pa-cenuarë, janë të kohës' së kufiturë për sendet' të gjetura ndë Lesh.

Gërrmimet' të Vithrëntitë kanë qiturë ndë dritë sende me vlejë të pa-të-çëmuarë për bukurij' e për mjeshtërijë. Ndofta dot' epet' volija të bëhet' fjalë për 'to ndë raportën' e vitit' 1930

Nga gërrmimet' që ndjek prej kaqë vjetësh ndë Pojan Zoti Prof. L. Rej (Prof. L. Rey) Muzeja Kombëtare pati me anën' e Mënistërijësë vetëm' një raportë të shkurtërë, ndë fund të së cilësë është shënuarë se gjithë sendet të xbuluara i jan' qënë dorëzuarë Zotit' Kryetar të Bashkijës' së Fjeritë.

Sende të falura. Përveç sa ushënuanë këtu parë kemi të shtojëm' dhe një shënim të vogëlë sendesh që, atdhetarë dhe dashamirë, patën' mirësijën' t' i falin' Muzejës' Kombëtare.

Ndër sa e sa dhurata t' jera shënojëm' simvjet këto:

Z-ja e tijë Z. Rauf Fico, fali (mbë 1923)
Një shtatëlë të vogëlë perëndije prej rami
Një unazë ramitë.
Një gur unaze gërshtalitë, me krye daci te gërvishturë.

Zoti Paal Soshi nga Durrësi (mbë 1923 dhe 1924)
Shtatëdhet' e shtatë moneza të herëshme ramitë.

Zoti Mehmet Myzyri --- Tiranë (mbë 1923).
Një kordhë ufiqeri të ushtërijës' së Turqijësë
Një çomige druri të drëdhurë të punuarë ndë Jemen (Arabijë).

BKSH

Zoti Maz'har Kulliqi — Tiranë (mbë 1922)
Njëzet' e pesë moneza ramit' të vjetëra dhe të vona.
Zoti Vahid Salih Dibra — Tiranë (mbë 1923)
Dy moneza të vjetra ramitë.
Zoti Veli Vasiari — Tiranë
Një flamur të Kongrës' së Lushnjësë mbë 1920.
Tetëmbëdhetë copë moneza të herëshme të Durrësit dhe të Pojanit, ergjënditë
Dy moneza ramit' të herëshmë.
Zotërinjtë Epaminonda dhe Thimi Çili — Korçë.
Njëqind moneza të ergjëndëta të Durrësit' dhe të Pojanitë.
Zoti Avukat Boris Petkof — Sofje
Nje monezë bulgare të vjetërë, ergjënditë.
Zoti Injgj. Kristo Papavangjeli — Gjinokastërë
Një monezë të vjetërë, ergjënditë.
Zoti Jërodjak Kostandin Noni — Stamboll
Një krësobulë të Prengërijës' së Hungro-Vllahijës' të vitit' 1749, mbi pargaminë.
Tri kora të shenjta të punuara me biser, të cenuara.
Nje pëhar të baltëtë, të gjetur bashkë mè tri koratë ndë rrenimet' të kishës' së Sh. Tërjadësë në Eksaqëjon të Stambollite.
Dy hire të shkruarë ndë gjuhë jëbranishte, mbi pargaminë, për krahë dyerësh shtëpijash të Jëvritëvetë.
Zoti Mexhit Jegeni — Tiranë
Një monezë të vjetërë të Tyrqijësë, ergjënditë.
Zoti S. Kolea
Gjashtëdhet' e dy moneza të vjetëra dhe të vona.

BKSH

Biblëjoteka për Djelmërijënë

Mbë 14 Korrik 1929 çeli dyertë ndë Tiranë „Biblëjoteka për Djelmërijënë" è ngrehurë me ndihmën' dhe të përpjekurat' të Zonjës' shpirt' e zëmërbardhë Ledit' Karnarvon (Lady Carnarvon) për kujtim të birit' të saj dhe bamirësit' të math të Shqipërijësë Sër Obrej Herbert (Sir Aubrey Herbert).

Themelit'-e storatësit' zëmërëmëdhej' të kësaj' Biblëjoteke kanë marurë para sysh sidomos nevojat' për shvëllim të mëndjes' dhe të ndjejtave fisnike dhe të nalta të masës' së re Shqipëtare. Edhe pemët' që ka dhënë kjo vepërë ndë pakë koh' e sipërë apin' shpëresa të mëdha se qëlllmi i shenjtë i dashamirëvet' të djelmërijës' s' ënë ka për të dalurë ndë faqe me fitim të plotë.

Drejtorija dhe Kumësija e Biblëjotekës' Kombëtare, ndë mbëledhën' e së 13[së]' së Korrikutë 1929, kanë çfaqur' gëzimin' dhe falënderjenë edhe kanë përshëndeturë me urime të nxehëtë vepërën' e çëmuarë të Zjës' së sajë Zonjës' Karnarvon për djelmërijën' e kësaj' toke.

Për të dhënë një pasqyrë sa mëë të plotë të dëshirës' së mësimit' ndë Kryeqytet, Drejtorija e Biblëjotekës' Kombëtare kujtoj' të nevojëshmë të shtronjë ndë raportën' e sajë sa mëë shumë shënime për vepërimin 'e „Biblëjotekës për Djelmërijënë'„ mbë 1929.

Me këtë dëshirë pati mirësijën' te pajtonjë dhe Drejtorija e sajë dhe me zemërë të gatijëtë na raditi me shënimet' që shtrojëm' këtu pas.

Për kohën 14 Korrik gjer 31 Dimëruar 1929, domethenë për 146 ditë punë, hynë ndë Biblëjotekën' për Djelmërijënë 1132 vehtë.

Vivëlla për këndim ukërkuanë 1154 vepëra të ndryshëme.

Numuri i vivëllavet' të falura Biblëjotekës' për Djelmërijën harrin 1439 copë, nga të cilatë:

1269 copë i a dhuruanë dashamirë Inglizë
82 „ „ „ „ „ Shqipëtarë
64 „ „ „ „ „ Frënjgjë
21 „ i a fali Lega e Shoqërijavet' të Kryqit' të Kuq.

Ndër dhuruarësit' Shqiptarë janë shënuarë:

Z-ja e tijë Z. Mehdi Frashëri	Tiranë (vepëra të vehta)	4
„ „ „ „ Rauf Fico	„	4
Zoti Mid'hat Frashëri	Tiranë	8
„ Hafës Ibrahim Dalliu	„ (vepëra të vehta)	4
„ Shemsedin D. Vëndresha	„	6
„ Loni Kristo	Korçë	7
„ Ferit Vokopola	Tiranë (vepëra të vehta)	
„ Kost. Çekrezi	„	
„ Hajredin Muhaxhiri	„	
„ F. Kazazi	„	
„ Rexhep Luga	„	
„ Sadik Hysejn Usta	„	
Shtypëshkronja „Djelli“	„	
Zoti N. E. Çipi	Korçë (vepëra të vehta)	
„ Stavri Frashëri	Korçë	
„ Must. Kruja	Zara (vepëra të vehta)	
„ Skënder Cilka	Amerikë	
Mënistërij' e Arësimitë		9 cope
Biblëjoteka Kombëtare		3 copë

Vivëllat' që bleu Biblëjoteka për Djelmërijënë mbë 1929 qenë 742 vepëra të ndryshëme.

BKSH

AR/406
KONTROLLI
1974-197

Gazeta dhe rëvista të lëshuara ndë sallën' e këndimitë qenë

Gazetatë:	Arbënija	Tiranë
	Ora	„
	Vullneti i Populit'	„
	Gazeta e Korçësë	Korçë
	Zëri i Korçësë	„
	Djelli	Boston
	Gazeta Shqipëtare	Bari
	Shqipërija e Re	Kostanxë
Rëvistatë:	Bujqësija	Tiranë
	Edukata e Re	„
	Laboremus	„
	Shqipëtarja	„

dhe disa rëvista inglisht për mësim dhe stërvitje të rinjësh.

Ndë programën' e Biblëjotekës' për Djelmërijënë është marurë para sysh dhe pika e bisedave të publiqëta për ndriçim të masës' së re dhe të popullitë.

Ndë Gusht dhe ndë Vjeshtë të Parë të vitit' të kaluarë ubënë ndë sallën' e sajë tri biseda me lëndë të ndryshëme.

Drejtorija e Biblëjotekës' e trimëruarë nga hiri i mirë që gjetën' këto biseda ndë botën' e Kryeqytetitë, ka vënë gjithë fuqijënë për t' i bërë sa mëë të shpeshëta, me lëndë gjithëherë sa mëë të zgjedhurë.

V 97.98
V 1989
DKSH

BKSH

BKSH

BKSH